



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:091503
Datë: 09.08.2024
Numri i dokumentit: 06038432

C.nr.1541/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Diora Bajrami, në çështje juridike kontestimore të paditësit E.K. nga Prizreni të cilin me autorizim i përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.....” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensim dëmi, jashtë seance, më datë 09.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

- I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit E.K. nga Prizreni me të cilën kanë kërkuar që “ të DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E.....” me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia kompensoj dëmin material në automjet në shumë prej 1.000euro me kamatë ligjore 8% duke llogaritur prej datës së parashtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim”, si e pabazuar.

A r s y e t i m

Paditësi E.K. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij avokat D.M. pranë kësaj gjykate me dt. 10.05.2022 ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “E.....” me seli në Prishtinë që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 03.07.2021 ti paguaj shumën prej 1000euro.

Me dt. 08.08.2024, gjykata nga i autorizuari i paditësit ka pranuar parashtrësën me të cilën e ka njoftuar gjykatën se paditësi nuk ka më interes për vazhdimin e procedurës pasi që me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtë gjyqësore andaj mbi këtë bazë kanë hequr dorë nga padia dhe kërkesëpadia.

Me nenin 3 par. 1 të LPK-së është paraparë se “Palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko – civile që i kanë parashtruar gjatë procedurës”, ndërsa me par.2 të këtij neni është paraparë se “Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë pajtim gjyqësor lidhur me kontestin e tyre”.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësve, konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) – me të cilin përcaktohet se “*në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)*” - pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, e bazuar në nenin 3 par. 1 dhe par. 2, lidhur me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1541/2022, datë 09.08.2024

G j y q t a r j a

Diora Bajrami

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Në kuptim të nenit 181 par. 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkakun se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.

Numri i lëndës: 2022:091503
Datë: 09.08.2024
Numri i dokumentit: 06038432